



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 183**

**dhjetor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 127/2012 datë 27.12.2012	Për ratifikimin e ndryshimit të parë të memorandumit të mirëkuptimit për krijimin, organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe plotësimin me ekip të Qendrës së NATO-s për Bashkërendimin e Operacioneve Speciale (NSCC) ..... 10813
Ligj nr. 128/2012 datë 27.12.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet të dyja vendeve ..... 10816
Ligj nr. 129/2012 datë 27.12.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin” ..... 10824
Ligj nr. 130/2012 datë 27.12.2012	Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga Policia e Shtetit deri në datën 30.12.2010 ..... 10825
Dekret nr. 7866 datë 20.12.2012	Për lirim ambasadori nga detyra ..... 10826
Dekret nr. 7869 datë 20.12.2012	Për emërim ambasadori në detyrë ..... 10827
Dekret nr. 7908 datë 30.12.2012	Për emërim ambasadori në detyrë ..... 10827
Vendim i KM nr. 939, datë 26.12.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 535, datë 7.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2012-2013”, të ndryshuar ..... 10828

Udhëzim i MF, MD nr. 6915/2, datë 30.1.2012	Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit .....	10829
Udhëzim i MITIK nr. 1, datë 31.12.2012	Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike .....	10830
Vendim i ERE nr. 171, datë 24.12.2012	Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. për lënien peng të aseteve të saj si kolateral pranë BERZH-it .....	10831
Vendim i ERE nr. 172, datë 24.12.2012	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Erma M.P” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec “Carshovë”, si burim i rinovueshëm energjie .....	10832
Vendim i ERE nr. 173, datë 24.12.2012	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga hecet “Arras”, “Funares”, “Dukagjin”, “Nikolice”, “Bulqize”, “Lurë”, “Orgjost”, “Lekbibaj”, “Velcan”, “Zerqan”, “Borsh”, “Leshnice”, “Shoshan”, “Ujanik”, “Kerpice”, “Barmash”, “Lunik”, “Homesh”, “Muhur”, “Rajan”, “Marjan” dhe “Treske 2”, si burime të rinovueshme energjie .....	10833
Vendim i ERE nr. 174, datë 24.12.2012	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec “Smokthina” si burim i rinovueshëm energjie.....	10834
Vendim i ERE nr. 175, datë 24.12.2012	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec “Vithkuq”, si burim i rinovueshëm energjie.....	10835
Vendim i ERE nr. 176, datë 24.12.2012	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Duka T2” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec “Tucep 2”, si burim i rinovueshëm energjie .....	10836
Vendim i ERE nr. 177, datë 24.12.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Duka T2” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Tucep 2” .....	10837
Vendim i ERE nr. 178, datë 24.12.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Erma M.P” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	10838
Vendim i ERE nr. 179, datë 28.12.2012	Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike .....	10839

**LIGJ**  
**Nr. 127/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË PARË TË MEMORANDUMIT TË  
MIRËKUPTIMIT PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË,  
FINANCIMIN DHE PLOTËSIMIN ME EKIP TË QENDRËS SË NATO-S PËR  
BASHKËRENDIMIN E OPERACIONEVE SPECIALE (NSCC)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 e 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i parë i memorandumit të mirëkuptimit për krijimin, organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe plotësimin me ekip të Qendrës së NATO-s për Bashkërendimin e Operacioneve Speciale (NSCC), sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7923, datë 11.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**AMENDAMENTI I PARË I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT (MiM) NDËRMJET  
DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES TË SHTETEVE TË BASHKUARA DHE MINISTRISË  
SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES  
TË MBRETËRISË SË BELGJIKËS, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS  
SË BULLGARISË, DHE DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES KOMBËTARE TË  
KANADASË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË ÇEKISË, DHE  
MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË DANIMARKËS, DHE MINISTRIT TË  
MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË FRANCËS DHE MINISTRISË FEDERALE TË  
MBROJTJES TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, DHE MINISTRISË SË  
MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË, DHE MINISTRISË SË  
MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË HUNGARISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË  
REPUBLIKËS SË ITALISË, DHE MINISTRISË TË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË  
LETONISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË  
LITUANISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË HOLANDËS, DHE  
MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË NORVEGJISË, DHE MINISTRIT TË  
MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË POLONISË, DHE MINISTRIT TË  
MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË PORTUGALISË, DHE MINISTRISË RUMUNE TË**



**MBROJTJES KOMBËTARE, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË  
SLLOVAKISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË,  
DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË SPANJËS, DHE SHTABIT TË  
PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË TURQISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË  
MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT,  
DHE SHTABIT TË PËRGJITHSHËM SUPREM TË FUQIVE ALEATE EUROPIANE  
(SHAPE) LIDHUR ME KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË,  
FINANCIMIN DHE PLOTËSIMIN ME EKIP TË QENDRËS KOORDINUESE TË  
OPERACIONEVE SPECIALE TË NATO-S**

Në përputhje me seksionin XVIII të memorandumit të mirëkuptimit, nënshkruarit në këtë mënyrë ndryshojnë memorandumimin e mirëkuptimit si më poshtë:

1. Të gjithë termat në këtë dokument mbartin të njëjtin kuptim, ashtu siç parashikohen në memorandumimin e mirëkuptimit.

2. Zëvendësoni frazën “Qendra e Koordinimit të Operacioneve Speciale të NATO-s” përgjatë memorandumit të mirëkuptimit me “Shtabi i Operacioneve Speciale të NATO-s”. Në të njëjtën mënyrë zëvendësoni inicialet “NSCC” përgjatë memorandumit të mirëkuptimit me inicialet “NSHQ”, përveç kur konteksti kërkon që inicialet të mbeten “NSCC”.

3. Zëvendësoni termin “drejtor” me termin “komandant” përgjatë memorandumit të mirëkuptimit.

4. Në paragrafin e pestë hyrës, nën titullin “Hyrje” zëvendësoni fjalët “nëpërmjet përmirësimit” me fjalët “përmirësimi i” para “aftësive për pajisje” në fund të fjalisë së fundit.

5. Në paragrafin e dhjetë hyrës, nën titullin “Hyrje”, hiqni të gjithë paragrafin dhe zëvendësojeni atë si më poshtë:

“Duke vërejtur se NATO MCN-423-2009 “Riorganizimi i Qendrës së Koordinimit të operacioneve speciale të NATO-S (NSCC) si Shtabi i Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ) 8 shtator 2009. Komiteti ushtarak i NATO-s mbështeti riorganizimin e NSCC-së si NSHQ”.

6. Në paragrafin e njëmbëdhjetë hyrës nën titullin “Hyrje”, hiqni të gjithë paragrafin dhe zëvendësojeni si më poshtë:

“Duke vërejtur marrëveshjen teknike ndërmjet SHAPE-it dhe Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara lidhur me komandimin dhe kontrollin e NSCC-së nga NATO-ja të ndryshuar për të mbuluar masat e komandimit dhe të kontrollit për NSHQ-në”.

7. Hiqni plotësisht paragrafin e trembëdhjetë hyrës nën titullin “Hyrje”, që përbëhet nga fjalia “duke vërejtur që NSCC është një qendër koordinuese dhe këshilluese pa funksione komanduese”.

8. Hiqni plotësisht paragrafin 1.3.

9. Hiqni plotësisht paragrafin 2.2 dhe zëvendësojeni me sa më poshtë:

“2.2 Qëllimi i këtij memorandumimi mirëkuptimi bazohet në konceptin e iniciativës transformuese të Forcave Speciale Operacionale të NATO-s (NSTI) me NSHQ që zëvendëson NSCC si qendër e iniciativës transformuese (NSTI). Ky koncept ishte baza e MCM-143-2006, MCM-190-2006. MCM-0069-2008 dhe MCM-0123-2009. Qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit mbështet rolin e NSHQ si një organizatë shumëkombëshe me një marrëdhënie komanduese të përhershme me SACEUR dhe aftësi për të ushtruar komandim dhe kontroll mbi NATO SOF (Forcat Speciale Operacionale të NATO-s) në nivel komponenti mbas transferimit të autoritetit, bazuar në përvojën e gjatë dhe burimet e Forcave Speciale Operacionale për të mundësuar trajnimin dhe përdorimin e tyre; sinkronizimin e Forcave Speciale Operacionale përgjatë Aleancës NATO në bashkëpunim me SHAPE. Komandat e forcave të përbashkëta (JFCs), si dhe entitetet kombëtare të Forcave Speciale Operacionale me qëllimin final të sigurimit të unitetit të përpjekjes së Forcave Speciale Operacionale të NATO-s. Memorandumi i mirëkuptimit mbështet aftësinë e NSHQ-së për

të integruar planifikimin e Forcave Speciale Operacionale të NATO-s, për të siguruar një politikë dhe doktrinë të përbashkët të kombinuar të Forcave Speciale Operacionale, për të mbështetur procesin e gjenerimit të forcës të Forcave Speciale Operacionale të NATO-s dhe për të përmirësuar ndërveprimin e forcave të pjesëmarrësve”.

10. Hiqni tekstin e paragrafit 3.1 dhe përfshini si më poshtë:

“a) NSHQ-ja mbetet pika kryesore e zhvillimit, drejtimit dhe koordinimit për të gjitha aktivitetet që lidhen me operacionet speciale të NATO-s, me qëllim optimizimin e përdorimit të Forcave Operacionale Speciale për të përfshirë sigurimin e një aftësie operacionale komanduese kur drejtohet nga SACEUR-i.

b) NSHQ-ja mundëson sinkronizimin e Forcave Operacionale Speciale në të gjitha vendet e NATO-s, kontribuon në unitetin e përpjekjeve të Forcave Operacionale Speciale të NATO-s dhe siguron për SACEUR-it një planifikim të operacioneve ekspeditore shumëkombëshe dhe aftësinë e komandimit dhe kontrollit për përdorim në një mision të aleancës, sipas udhëzimeve”.

11. Hiqni plotësisht paragrafin 3.2 dhe zëvendësojeni me:

“NSHQ-ja ngarkohet drejtpërsëdrejti dhe posaçërisht nga SACEUR-i në përputhje me procedurat e NATO-s. Marrëdhëniet vartëse dhe marrëdhëniet e komandimit që mundësojnë NSHQ-në të kryejë detyrat e saj në kohë paqeje, krize dhe operacionet do të realizohen në përputhje me dispozitat e marrëveshjes teknike ndërmjet Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe SHAPE. SHAPE do të konsultohet me pjesëmarrësit para çdo ndryshimi të marrëveshjes teknike”.

12. Hiqni plotësisht paragrafin 4.2 dhe zëvendësojeni si më poshtë:

“Statusi i Shtabit të Përgjithshëm Ndërkombëtar Ushtarak (IMHQ) i parashikuar nga Protokollit i Parisit dhe çdo marrëveshje plotësuese dhe implementuese e Protokollit të Parisit sipas vendimit të Këshillit të Adriatikut Verior (NAC) mbi shpërndarjen e NSCC dhe aktivizimin e NSHQ-së si trupi ushtarak i NATO-s nëpërmjet PO (2009)-0135, 24 shtator 2009.”.

13. Përfshini paragrafin e ri 7.8:

“Të gjithë anëtarët e stafit të NSHQ-së janë të përshtatshëm për angazhim dhe detyra të përkohshme sipas përkohshimit të detyrave të tyre, në varësi të ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe me miratim të NMR-së ose SNR-së përkatëse në emër të pjesëmarrësit.”.

14. Hiqni plotësisht paragrafin 12.4.

15. Në rreshtin e shtatë të paragrafit 16.1 hiqni fjalët “nënshkruesit” dhe zëvendësojeni me fjalën “pjesëmarrësi”.

16. Në rreshtin e parë të paragrafit 18.2, zëvendësoni termin “NSC” me “struktura komanduese të NATO-s”.

Ky amendament i parë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të fundit si më poshtë. Ky amendament i parë hartohet në gjuhën angleze në një kopje origjinale. Kopje të njësuar me origjinalin do t’i sigurohen secilit pjesëmarrës të NSHQ-së nga ana e SHAPE-s.



**LIGJ**  
**Nr. 128/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR KRYERJEN E  
TRANSPORTIT HEKURUDHOR KUFITAR NDËRMJET TË DYJA VENDEVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet të dyja vendeve.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7924, datë 11.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**QEVERISË SË MALIT TË ZI MBI KRYERJEN E TRANSPORTIT HEKURUDHOR KUFITAR**  
**NDËRMJET TË DYJA VENDEVE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (të referuara më poshtë si palët kontraktuese),

*duke dëshiruar* të adaptojnë procedurën e organizimit të transportit kufitar hekurudhor, të vendosur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, me anë të marrëveshjes për organizimin e trafikut kufitar hekurudhor ndërmjet të dyja vendeve, të nënshkruar më 16 maj 2006, me kërkesat e reja të tregut me qëllim rritjen e aftësisë konkurruese të shërbimeve hekurudhore,

palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë marrëveshjen e re ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, mbi kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet dy vendeve (këtej e tutje e quajtur si marrëveshja),

me dispozitat e mëposhtme:

## Neni 1 Përkufizimet

Për qëllime të zbatimit të marrëveshjes, do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. “Kryerja e transportit kufitar” do të thotë zbatimi i të gjitha rregullave dhe rregulloreve të palëve kontraktuese dhe autoriteteve hekurudhore që zbatohen për kalimin e kufirit të personave dhe të bagazheve, si dhe për importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave.

2. “Deklarata e rrjetit kufitar” do të thotë deklarata që përcakton në detaje rregullat e përgjithshme, afatet, procedurat dhe kriteret në lidhje me tarifatat dhe skemat e shpërndarjes të kapaciteteve të infrastrukturës në zonë. Ajo duhet, gjithashtu, të përmbajë informacione të tjera të kërkuara për të bërë të mundur aplikimin për kapacitetin e infrastrukturës dhe mund të jetë pjesë përbërëse e deklaratës së rrjetit kufitar të administruesit të infrastrukturës së palëve kontraktuese.

3. “Vija kufitare hekurudhore” është vija hekurudhore midis stacioneve kufitare të të dyja vendeve.

4. “Seksioni kufitar” është pjesa e vijës hekurudhore midis stacionit kufitar dhe kufirit shtetëror të palëve kontraktuese.

5. “Stacion kufitar” është një stacion hekurudhor në zonë, i përcaktuar në marrëveshje.

6. “Shtet vendas” është shteti, territori i të cilit është pjesë e zonës, ku do të kryhet transporti kufitar nga ana e personelit zyrtar të shtetit tjetër.

7. “Hekurudha vendase” do të thotë hekurudha e shtetit vendas.

8. “Mallrat” janë të gjitha sendet, paratë, pakot, bagazhet dhe mjetet e transportit të transferuara nëpërmjet kufirit shtetëror.

9. “Administruesi i infrastrukturës” është çdo kompani, ent ligjor ose ndërmarrje që i është dhënë e drejta për administrimin e infrastrukturës hekurudhore. Kjo mund të përfshijë edhe administrimin dhe rregullimin e sistemeve të transportit, të kontrollit dhe të sigurisë.

10. “Shërbimi hekurudhor ndërkombëtar” është çdo shërbim i transportit të mallrave dhe udhëtarëve, ku treni kalon kufirin e palës kontraktuese; treni mund të bashkohet dhe/ose të ndahet, dhe seksionet e ndryshme mund të kenë origjinën dhe destinacione të ndryshme, me kusht që të gjithë vagonët e mallrave dhe të udhëtarëve të kalojnë kufirin.

11. “Rrjet” nënkupton të gjithë infrastrukturën hekurudhore në pronësi dhe/ose të drejtuar nga një administrues i infrastrukturës.

12. “Shtet fqinj” është territori i shtetit të palës tjetër kontraktuese.

13. “Personeli zyrtar” nënkupton personat e autoriteteve kufitare shtetërore kompetente të palëve kontraktuese, që kryejnë kontrollin e detyrueshëm kufitar në territorin e shteteve vendase dhe fqinje, si edhe lëvizjen e trenave.

14. “*One-stop-shop* (OSS)” do të thotë vendi i administruesit të infrastrukturës së palëve kontraktuese, i cili, së bashku me përfaqësuesit e administruesve të tjerë të infrastrukturës, formojnë rrjetin ndërkombëtar, ku përdoruesve u krijohen lehtësira për të hyrë në infrastrukturën hekurudhore ndërkombëtare në zonë;

15. “Dritare e vetme” nënkupton vendin ku të gjitha shërbimet doganore të kryhen në një dhe të vetmin vend në zonë nga autoritetet doganore të palëve kontraktuese.

16. “Personeli hekurudhor” është i gjithë personeli që në emër të një transportuesi hekurudhor ose të një administruesi të infrastrukturës hekurudhore, merr pjesë në kryerjen e transportit hekurudhor kufitar.

17. “Transportues hekurudhor” është çdo ndërmarrje publike ose private e licencuar në bazë të legjislacionit të zbatueshëm të palëve kontraktuese, veprimtaria kryesore e të cilit është të ofrojë shërbime për transportin hekurudhor të mallrave dhe/ose udhëtarëve dhe që siguron vetë tërheqjen.

18. “Stacioni i përbashkët kufitar” është stacioni kufitar në zonë ku bashkërisht kryhet transporti kufitar.



19. “Zonë” është pjesë e territorit të shtetit vendas, në të cilën personeli zyrtar i shtetit fqinj është i autorizuar për të kryer transportin kufitar.

## Neni 2

### Dispozita të përgjithshme, objektivat dhe parimet

Objekti i kësaj marrëveshjeje është thjeshtimi i kryerjes së transportit kufitar dhe zvogëlimi i kohës së pritjes në pikat e kalimit kufitar, me anë të:

- kryerjes së veprimtarive të transportit kufitar të një shteti për në territorin e shtetit tjetër nga personeli zyrtar dhe hekurudhor;

- vendosjes së rregullave për kryerjen e transportit kufitar të një shteti në trenat që lëvizin në territorin e shtetit tjetër nga ana e personelit zyrtar ose hekurudhor;

- përcaktimit se:

- në cilin prej stacioneve të shtetit vendas, shteti fqinj mund të ngrejë pikat e transportit kufitar për kontrollin kufitar;

- në cilat zona autoritetet kufitare të shtetit fqinj mund të kryejnë transportin kufitar në stacionet edhe në trena në të dyja drejtimet në territorin e shtetit vendas;

- zonat.

Palët kontraktuese garantojnë:

- hyrje të lirë për transportuesit hekurudhorë, të cilët dëshirojnë të hyjnë në zonë me qëllim kalimin e kufirit me anë të një procedure të thjeshtuar të pranimit reciprok të licencave, të certifikatave të sigurisë, të tërheqjes së mjeteve lëvizëse dhe të lejeve të drejtimit për drejtuesit e lokomotivave;

- mosdiskriminim dhe konkurrencën e ndershme në lidhje me hyrjen e lirë;

- pranimin e standardeve ndërkombëtare, si dhe të dokumenteve të mallrave dhe të udhëtarëve;

- pranimin e dokumenteve të tjera të transportit, të njohura ndërkombëtarisht;

- liria e ndërmarrjeve hekurudhore për të organizuar procedurat e veta të transportit kufitar hekurudhor, duke bërë marrëveshje me autoritetet kufitare respektive, sipas përcaktimeve të protokolleve;

- liria e autoriteteve kufitare për të përfunduar protokolle të veçanta dypalëshe me njëri-tjetrin, veçmas;

- e drejta e policisë së kufirit të shtetit fqinj për të kryer kontrolle në territorin e shtetit vendas në zonë;

- e drejta e autoriteteve doganore për të krijuar një sportel të vetëm shërbimi në zonë;

- e drejta e autoriteteve fito-sanitare, veterinare, sanitare dhe shëndetësore anti-epidemiologjike dhe çdo autoriteti tjetër të caktuar nga çdo palë kontraktuese për të kryer kontrolle në zonën e territorit të shtetit vendas dhe të pranojnë respektivisht certifikatat dhe kontrollet reciproke.

Palët kontraktuese bien dakord të publikojnë në faqen e internetit të gjitha dokumentet dhe procedurat që kërkohen nga autoritetet kufitare dhe nga administruesit e infrastrukturës për një kalim të qetë të kufirit.

Palët kontraktuese bien dakord që administruesit e tyre të infrastrukturës hekurudhore të përgatisin dhe të hartojnë një deklaratë të përbashkët të rrjetit që përmban:

- procedura jodiskriminuese të pranimit në rrjet për transportuesit hekurudhorë për të hyrë në zonë;

- procedura e *one-stop-shop* për të lehtësuar pagesat e shërbimeve të infrastrukturës;

- procedura të përcaktimit të rrugëkalimeve;



- procedura jodiskriminuese për tarifat e infrastrukturës dhe faturimin e shërbimeve, që sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe lehtësi në bërjen e pagesave të mundshme nga transportuesit hekurudhorë.

### Neni 3

#### **Zona**

Zona do të përfshijë:

a) mjediset ku autoritetet kufitare të shtetit fqinj mund të kryejnë funksionet e tyre, shinat dhe linjat, stacionet e mallrave dhe të udhëtarëve, magazinat, objektet e pritjes për udhëtarët, ndërtesat dhe pajisjet e tjera;

b) trenat që lëvizin ndërmjet seksioneve të linjave ose stacioneve të caktuara, gjatë të cilave autoritetet kufitare kryejnë detyrat e tyre.

Dispozitat e përgjithshme, objektivat dhe parimet e përmendura në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje janë të vlefshme për zonën.

Në këtë marrëveshje zona përfshin:

a) stacionet kufitare Tuzi dhe Bajzë;

b) seksionet kufitare midis dy stacioneve;

c) seksionin midis stacionit të Tuzit dhe Bajzës për kontrollin e mjeteve të udhëtarëve në lëvizje;

d) seksionin midis stacionit të Tuzit dhe Bajzës për lëvizjen e trenave të mallrave.

Në kushtet e kësaj marrëveshjeje, stacioni i përbashkët kufitar do të jetë Tuzi.

Autoritetet kufitare të palëve kontraktuese janë të lira për të zgjeruar zonën për qëllimet e tyre, në përputhje me dispozitat e përgjithshme, objektivat dhe parimet e përcaktuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, duke lidhur protokolle dypalëshe të mëtejshme.

### Neni 4

#### **Transporti kufitar në zonë**

Në zonë, ligjet dhe rregulloret e shtetit fqinj janë të vlefshme në lidhje me kalimin e kufirit të personave, të mallrave (importin, eksportin dhe transitin) sipas parimeve të mëposhtme:

a) personat dhe mallrat do të trajtohen me të njëjtat procedura dhe do të kenë të njëjtat pasoja ligjore sikur të ishin në territorin e shtetit fqinj.

b) veprimet e tilla, si ato policore, doganore apo ndërhyrje të tjera, si dhe ndalimi i personave dhe bllokimi i mallrave, duhet të jenë në përputhje me protokolle të veçanta ndërmjet autoriteteve përkatëse të palëve kontraktuese.

Sipas protokolleve të veçanta, autoritetet e kufirit mund t'i transferojnë kompetencat e tyre të kalimit kufitar, autoriteteve kufitare të shtetit tjetër, në mënyrë që të arrihen objektivat dhe parimet e përcaktuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

Për sa kohë që autoritetet kufitare të shtetit fqinj, nuk i kanë transferuar kompetencat e tyre të kalimit kufitar, autoriteti kufitar të shtetit vendas, autoritetet kufitare të shtetit vendas do të kryejnë procedurat e përcaktuara përpara se autoritetet kufitare të shtetit fqinj të kryejnë procedurat e tyre. E njëjta gjë do të jetë e vlefshme edhe nëse personeli zyrtar i shtetit dalës refuzon kryerjen e procedurave dhe kontrollin kufitar.

Në një kohë që procedura e transportit kufitar të shtetit fqinj ka filluar, kompetencat e autoriteteve të shtetit vendas tashmë kanë përfunduar, përveç kur kanë ata arsye ligjore për të ndërhyrë, por vetëm me miratimin e autoriteteve përkatëse të shtetit fqinj.

Të drejtat në lidhje me azilin politik dhe të drejtat e njeriut në shtetin vendas do të mbeten në fuqi.



Personeli zyrtar i autoriteteve kufitare të shtetit fqinj, duke kryer funksionet e tyre në lidhje me kalimin kufitar në shtetin vendas, do të jenë përgjegjës vetëm ndaj autoriteteve të shtetit të tyre.

Personeli zyrtar i autoriteteve kufitare të shtetit fqinj, do të ketë të drejtë të kryejë funksione në zonën e shtetit vendas. Personeli është i detyruar të informojë autoritetet kompetente kufitare të shtetit vendas mbi veprimet dhe masat e ndërmarra. Shteti vendas është i detyruar të njoftojë menjëherë personelin e autoritetit kufitar respektiv të shtetit fqinj për vendimin e tij.

Në mënyrë që të arrihet një kontroll kufitar sa më i shpejtë, personeli zyrtar mund të negociojë dorëzimin e detyrave sipas përcaktimeve të nenit 4, paragrafi 7 të kësaj marrëveshjeje. Në një rast të tillë, personeli i autoritetit përkatës në shtetin hyrës do të ketë të drejtën për të arrestuar një person dhe/ose konfiskimin e mallrave, vetëm kur të ketë mbaruar kontrolli kufitar i shtetit dalës. Nëse personeli i autoritetit përkatës të shtetit hyrës do ta shohë të përshtatshme, atëherë personeli i shtetit dalës do të jetë i detyruar që të dorëzojë personat ose mallrat, personelit përkatës të shtetit dalës, përpara përfundimit të kontrollit kufitar.

Personeli i palëve kontraktuese është i detyruar të bashkëpunojë me njëri-tjetrin.

Personeli zyrtar i shtetit fqinj ka të drejtën e dërgimit falas të sendeve vetjake, të cilat janë ndaluar përkohësisht në zonë, si dhe burimet financiare të mbledhura në zonë, përmes kufirit shtetëror në territorin e shtetit të tij.

Sendet vetjake të kapura dhe të konfiskuara gjatë kontrolleve të kryera në dalje dhe të kthyer nga personeli zyrtar i shtetit fqinj, nuk do të jenë subjekt i inspektimit kufitar nga ana e personelit të shtetit vendas.

Protokollet ndërmjet autoriteteve të palëve kontraktuese do të përcaktojnë më hollësisht realizimin e kontrollit kufitar.

## Neni 5

### **Kontrolli kufitar në bordin e trenave të udhëtarëve**

Kontrolli kufitar i trenave të udhëtarëve do të kryhet bashkërisht, si në trenat që janë në lëvizje ose të ndaluar në stacionet kufitare nga personeli i autoriteteve kufitare të palëve kontraktuese.

Siguria e jashtme në stacionet kufitare të përbashkëta do të sigurohet në përputhje me rregulloret e shtetit vendas.

## Neni 6

### **Kontrolli kufitar në trenat e mallrave**

Kontrolli kufitar për trenat e transportit të mallrave do të kryhet në stacionin e përbashkët kufitar në zonë nga autoritetet kufitare të palëve kontraktuese.

Siguria e jashtme në stacionet e përbashkëta kufitare do të sigurohet në përputhje me rregulloret e shtetit vendas.

Çdo person i kapur nga autoritetet kufitare të palëve kontraktuese në kalimin e paligjshëm të kufirit, në trenat e mallrave në stacionin e përbashkët kufitar, do të jetë subjekt i ligjeve të autoritetit të shtetit vendas.

## Neni 7

### **Shkëmbimi i informacionit**

Gjatë kohës në detyrë, personeli zyrtar mund të shkëmbejë vetëm informacion të paklasifikuar, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. Shkëmbimi i informacionit do të kryhet mbi bazën e protokolleve të veçanta, të lidhura ndërmjet autoriteteve kufitare përkatëse të palëve kontraktuese.

## Neni 8 **Statusi i personelit zyrtar**

Gjatë kohës në detyrë, personeli i autoriteteve kufitare ka të drejtën e hyrjes së lirë në zonën e shtetit fqinj, me uniformë me ose pa armë. Personeli i shtetit fqinj merr të njëjtën mbrojtje dhe mbështetje si personeli i shtetit vendas.

Për personelin e tij, ligjet dhe rregullat e shtetit fqinj janë të vlefshme në zonë.

Personeli i tij zyrtar duhet të pajiset me karta të veçanta identifikimi për të vepruar brenda zonës.

Procedura e lëshimit përcaktohet në nenin 10 të kësaj marrëveshjeje.

Nëse dikush nga personeli i tij vritet ose plagoset, i humbin gjërat personale që i mban me vete (armët, uniformat etj.) gjatë detyrës, zbatohen ligjet dhe rregullat e shtetit fqinj.

Çështje të tjera, që lidhen me personelin zyrtar, do të rregullohen me protokolle të veçanta ndërmjet autoriteteve përkatëse kufitare.

Veprat apo shkeljet penale të kryera brenda zonës, të drejtuara kundër personelit zyrtar apo hekurudhor të shtetit fqinj që janë në detyrë, do të trajtohen në përputhje me legjislacionin e shtetit vendas, sipas të njëjta kushteve sikur t'i kishin ndodhur personelit zyrtar apo hekurudhor të shtetit vendas, procedurat përcaktohen me protokolle të veçanta.

Personeli zyrtar dhe hekurudhor i shtetit fqinj gjatë detyrës brenda në zonë duhet të ketë të veshur uniformën zyrtare dhe/ose simbole të dukshme zyrtare.

## Neni 9 **Lehtësitë e kalimit kufitar**

Në trena, ndërmarrjet hekurudhore janë të detyruara të sigurojnë kabina të rezervuara, pa pagesë, për personelin zyrtar në detyrë.

Në lidhje me përdorimin e hapësirës dhe dhomave në zonë, që u caktohen autoriteteve kufitare të shtetit fqinj, autoritetet kufitare do të lidhin kontratat përkatëse, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

Godinat zyrtare dhe mjetet duhet të identifikohen me mbishkrimin dhe me simbolin apo stemat kombëtare. Mbishkrimet në mjediset e zyrave shkruhen në gjuhët zyrtare të palëve kontraktuese dhe në gjuhën angleze, duke mbishkruar fillimisht gjuhën zyrtare të shtetit vendas.

Objektet e përdorura gjatë ushtrimit të detyrës nga personeli zyrtar dhe hekurudhor i shtetit fqinj në/ose jashtë territorit të shtetit vendas, nuk janë subjekt i deklarimit doganor dhe detyrimeve doganore ose detyrimeve të tjera.

Autoritetet kufitare janë të lira të lidhin protokollet përkatëse mbi çështjet e përmendura në këtë nen, në përputhje me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 10 **Karta e identitetit për personelin zyrtar dhe hekurudhor**

Në përputhje me nenin 8, paragrafi 3 të kësaj marrëveshjeje, kartat zyrtare të identitetit lëshohen nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese për një periudhë njëvjeçare. Afati i vlefshmërisë duhet të zyrtarizohet nga ana e organeve kompetente të të dyja palëve kontraktuese.

Autoriteti lëshues është i detyruar të shfuqizojë menjëherë kartën e identitetit në përfundim të arsyeve për të cilat ajo është lëshuar dhe është i detyruar të njoftojë menjëherë me shkrim autoritetet kompetente të shtetit fqinj.

Personeli hekurudhor që merr pjesë në organizimin e operacioneve të transportit, pa kartë identiteti, duhet të regjistrohet në listën e personelit. Modeli i listës tregohet në programin nr. 1.



Në rastin e paragrafit 3 të këtij neni, autoritetet që lëshojnë dokumentet duhet të informojnë menjëherë me shkrim autoritetet përkatëse të shtetit fqinj.

Personat e përmendur në listën e personelit, pa kartë identiteti, kanë të drejtë të kalojnë kufirin shtetëror brenda në zonë kur janë në detyrë dhe të qëndrojnë në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Të gjithë personat, emrat e të cilëve janë në listën e personelit, duhet të mbajnë pasaportë të vlefshme.

#### Neni 11

### **Pajisjet e telekomunikacionit**

Shteti vendas duhet të japë leje, pa pagesë, për instalimin e pajisjeve të telekomunikacionit që janë të domosdoshme për punën e autoriteteve kufitare të shtetit fqinj në shtetin vendas, si dhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet e duhura të shtetit fqinj.

Instalimi, mirëmbajtja dhe operimi i mjeteve të telekomunikacionit do të jenë subjekt i protokolleve ndërmjet autoriteteve përkatëse.

#### Neni 12

### **Gjuha**

Në stacionin e përbashkët kufitar, në stacionin kufitar, si dhe në linjën hekurudhore kufitare, gjatë komunikimit të personelit zyrtar dhe hekurudhor do të përdoren në mënyrë të barabartë gjuhët që janë në përdorimin zyrtar në të dyja shtetet.

Bisedat telefonike, komunikimet me gojë dhe/ose me shkrim, që lidhen me transportin hekurudhor, do të zhvillohen në gjuhët që janë në përdorimin zyrtar në të dyja shtetet.

#### Neni 13

### **Fondet e mbledhura zyrtarisht**

Personeli hekurudhor ka të drejtë të mbajë shumat e mbledhura për shërbimet hekurudhore përgjatë kufirit në të dyja drejtimet.

#### Neni 14

### **Komisioni i kalimit kufitar**

Palët kontraktuese do të krijojnë komisionin e kalimit kufitar, me qëllim që të garantojnë objektivat e mëposhtëm:

- të drejtë hyrjeje jodiskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore brenda zonës;
- krijimi i kushteve për konkurrencë të ndershme;
- gjykim ndërmjet administruesve të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore në lidhje me deklaratën e rrjetit kufitar;
- gjykim midis ndërmarrjeve hekurudhore që përdorin shërbimet hekurudhore kufitar;
- zgjidhje për problemet që lindin nga bashkëpunimi i autoriteteve kufitare në zonë;
- përmirësimi i shërbimeve kufitare;
- interpretimi i dispozitave në këtë marrëveshje.

Aktivitetet e komisionit të kalimit kufitar nuk përjashtojnë ndërhyrje ose zgjidhje diplomatike të çështjeve në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet partnerëve kontraktues.

Komisioni i kalimit kufitar do të përfshijë përfaqësues të të gjitha organeve shtetërore përgjegjëse për kontrollin kufitar, ministritë përgjegjëse për transportin, drejtoritë e hekurudhave dhe hekurudhat e të dyja shteteve.

Komisioni i kalimit kufitar do të mbledhet të paktën një herë në vit, në mënyrë alternative në territorin e njërit apo tjetrit shtet dhe, nëse është e nevojshme më shpesh, me kërkesë të njëres prej palëve kontraktuese.

Metoda e punës së komisionit të kalimit kufitar përcaktohet nga rregullat e procedurës që do të aproohen gjatë takimit të parë të tij.

#### Neni 15 **Vlefshmëria**

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar, me mundësinë e përfundimit të saj me nismën e secilës nga palët kontraktuese.

Vlefshmëria e marrëveshjes do të përfundojë gjashtë muaj pas ditës së marrjes së notës diplomatike, përmes së cilës pala tjetër kontraktuese njofton përfundimin e marrëveshjes.

#### Neni 16 **Hyrja në fuqi**

Marrëveshja i nënshtrohet ratifikimit dhe hyn në fuqi 30 ditë pasi palët kontraktuese të kenë informuar njëra-tjetrën përmes notave diplomatike se ratifikimi është kryer në përputhje me dispozitat e legjislacionit të tyre kombëtar.

Protokollet ndërmjet autoriteteve të veçanta kufitare, të përcaktuara në këtë marrëveshje, duhet të miratohen brenda afatit prej 90 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për organizimin e trafikut kufitar hekurudhor midis të dyja vendeve, e nënshkruar më 16 maj 2006 në Podgoricë, pushon së qeni e vlefshme nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar siç duhet nga qeveritë e tyre, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Nënshkruar në Podgoricë më 3 gusht 2012, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze dhe të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Programi nr. 1

#### LISTA E PERSONAVE QË KALOJNË KUFIRIN SHTETËROR PËR QËLLIME ZYRTARE

Në stacionin e përbashkët kufitar ose në stacionin kufitar (fshije nëse është e panevojshme)

Hekurudha \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_

Në orën \_\_\_\_\_, me \_\_\_\_\_

Kjo listë konsiderohet si shtojcë e lejes zyrtare për kalimin e kufirit shtetëror nr. \_\_\_\_\_  
që i përket \_\_\_\_\_



Numri rendor	Emri dhe mbiemri	Data dhe vendi i lindjes	Funksioni	Numri i kartës së identitetit	Vërejtje

Data \_\_\_\_\_

Drejtuksi i stacionit \_\_\_\_\_

Vërtetuar nga autoriteti shtetëror  
në dalje \_\_\_\_\_

Vërtetuar nga autoriteti shtetëror  
në hyrje \_\_\_\_\_

**LIGJ**  
**Nr. 129/2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 64/2012, DATË 31.5.2012 “PËR PESHKIMIN”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 72 pika 1, fjalët “më të madhe se 15 m”, zëvendësohen me fjalët “më të madhe se 12 m”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7925, datë 11.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

<sup>1</sup> Ky ligj është përafuar plotësisht me:

*Rregulloren e Këshillit nr. 1224/2009/KEE, datë 20 nëntor 2009 “Mbi krijimin e një sistemi kontrolli komunitar për të garantuar respektimin e rregullave të politikës së përbashkët të peshkimit”, e cila ndryshon rregulloret nr. 847/96/KE, nr. 2371/2002/KE, nr. 811/2004/KE, nr. 768/2005/KE, nr. 2115/2005/KE, nr. 2166/2005/KE, nr. 388/2006/KE, nr. 509/2007/KE, nr. 676/2007/KE), nr. 1098/2007/KE, nr. 1300/2008/KE, nr. 1342/2008/KE dhe shfuqizon rregulloret nr. 2847/93/KEE, nr. 1627/94/KE dhe nr. 1966/2006/KE. Numri CELEX 32009R1224, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 343, datë 22.12.2009, faqe 1-50.*

**LIGJ**  
**Nr. 130/2012**

**PËR TRAJTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E MJETEVE RRUGORE E LUNDRUESE TË  
KONFISKUARA, SI PASOJË E SEKUESTRIMIT, NDALIMIT APO BLOKIMIT NGA  
POLICIA E SHTETIT DERI NË DATËN 30.12.2010**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**MJETET RRUGORE**

**Neni 1**

Mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit deri në datën 30.12.2010, për të cilat nuk ka probleme në ndjekje, në hetim ose verifikime të ndryshme, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

**Neni 2**

Mjetet rrugore, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare (me ose pa targa regjistrimi/leje qarkullimi nga një shtet i huaj) dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, pas rikonfirmimit të verifikimeve me shtetet e origjinës, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

**KREU II**  
**MJETET LUNDRUESE**

**Neni 3**

Mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe me certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit deri në datën 30.12.2010, për të cilat nuk ka probleme në ndjekje, në hetim ose verifikime të ndryshme, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

**Neni 4**

Mjetet lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare (me ose pa leje



lundrimi nga një shtet i huaj) dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, pas rikonfirmimit të verifikimeve me shtetet e origjinës, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

### KREU III

#### Neni 5

Kalimi i këtyre mjeteve nga mjediset e drejtorive të policisë së qarqeve përkatëse dhe ato të Policisë Kufitare dhe Migracionit bëhet pranë mjediseve të drejtorisë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, që korrespondon me territorin respektiv. Procedurat e kalimit dhe të çregjistrimit rregullohen me akt nënligjor të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transporteve.

#### Neni 6

Të ardhurat e gjeneruara, sipas përcaktimeve në nenet 1, 2, 3 e 4 të këtij ligji, të përdoren sipas legjislacionit në fuqi. Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme ngarkohen të nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të këtij neni.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.12.2012

**Shpallur me dekretin nr.7926, datë 11.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

### DEKRET

**Nr. 7866, datë 20.12.2012**

### PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit

### DEKRETOJ:

#### Neni 1

Zoti Llesh Kola lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Italisë, rezident, si dhe nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maltës, në Republikën e San Marinos dhe pranë Organizatës Ndërkombëtare të Bujqësisë dhe Ushqimit “FAO”, jorezident.



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
Nr. 7869, datë 20.12.2012

**PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Neritan Ceka emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Italisë, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maltës, në Republikën e San Marinos dhe pranë Organizatës Ndërkombëtare të Bujqësisë dhe Ushqimit “FAO”, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
Nr. 7908, datë 30.12.2012

**PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Genci Muçaj emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Azerbajxhanit, në Republikën Islamike të Iranit, Republikën e Kirkistanit, Republikën Islamike të Pakistanit dhe në Republikën e Gjeorgjisë, jorezident.



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**VENDIM**  
**Nr. 939, datë 26.12.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 535, DATË 7.8.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË  
ARSIMIT TË LARTË PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PJESSHME E  
TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2012-2013”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Shkronjat “a” dhe “ë” të pikës 1 të vendimit nr. 535, datë 7.8.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen si më poshtë vijon:

“a) Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë,  
me kohë të pjesshme 9035;”

...

“ë) Kuota për të përndjekurit politikë 280.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr. 6915/2, datë 30.1.2012**

**MBI PROCEDURAT TEKNIKE PËR DERDHJEN E PAGESËS SË TJETËRSIMIT NË  
LLOGARINË BANKARE TË NOTERIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 49 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave

**UDHËZOJNË:**

1. Noteri duhet të ketë llogari rrjedhëse pranë një banke, të dedikuar për kryerjen e transaksioneve të tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.

2. Kjo llogari duhet të jetë e ndryshme nga llogaria bankare që noteri përdor si person fizik ose si individ dhe nuk duhet të gjenerojë interesa.

3. Kur palët (shitësi dhe blerësi) paraqiten para noterit për lidhjen e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, noteri menjëherë kontrollon *on-line*, në regjistrin elektronik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nëse shitësi është pronar dhe realizon kontratën.

Në kontratë duhet të pasqyrohet edhe mënyra e derdhjes së çmimit të tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.

4. Me realizimin e kontratës, pala blerëse duhet të derdhë çmimin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në llogarinë bankare të noterit. Për këtë qëllim blerësi pajiset nga noteri me të dhënat e sakta në lidhje me emërtimin dhe numrin e llogarisë bankare.

Vetëm pas paraqitjes së dokumentit bankar që vërteton se çmimi i tjetërsimit është derdhur në llogarinë e noterit, kontrata firmoset nga të dyja palët.

5. Kontrata e tjetërsimit e noterizuar, dorëzohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 10 ditëve, nga dita e nënshkrimit të kontratës nga kërkuesi, noteri apo asistenti i tij.

Në rastet kur noteri bën kërkesën për regjistrimin e veprimeve juridike, të fitimit apo të kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme dhe marrjes së certifikatave të pronësisë, tërheq nga shuma e derdhur në llogarinë bankare, nga blerësi, 10% të fitimeve kapitale të realizuara në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”.

6. Noteri derdh tatimin lidhur me kalimin e së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme në llogarinë bankare të ZRPP-së dhe paraqet dokumentin bankar që konfirmon kryerjen e transaksionit në ZRPP për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme.

7. Me marrjen në dorëzim të certifikatës së pronësisë, brenda 24 orëve, noteri transferon në llogarinë bankare të shitësit shumën e depozituar nga blerësi në llogarinë bankare të tij, duke zbritur komisionin bankar të aplikuar nga banka për transfertën.

8. Transferimi i shumës nga llogaria bankare e noterit në llogarinë e shitësit, do të bëhet nga noteri në përputhje me rregullat përkatëse bankare.

9. Shumat e depozituara në llogarinë e noterit mbahen për llogari të palëve, për të cilat janë marrë dhe mbahen këto para. Veprimet përmbartimore dhe/ose ato të administratës tatimore qendrore ose vendore, me qëllim ekzekutimin e detyrimeve të noterit kundrejt palëve të treta, nuk mund të shtrihen mbi këtë llogari bankare të dedikuar për kryerjen e transaksioneve të tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.



10. Ngarkohen noterët dhe strukturat përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Ridvan Bode**

**MINISTRI I DREJTËSISË**  
**Eduard Halimi**

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 31.12.2012**

**PËR VËRTETIMIN E KOPJES NË LETËR TË DOKUMENTIT ELEKTRONIK**  
**NGA INSTITUCIONET PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102 paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të paragrafit 1 të nenit 10 dhe të pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr. 10 273/2010 “Për dokumentin elektronik”, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit

**UDHËZON:**

1. Autoriteti kompetent për lëshimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik është institucioni, i cili krijon dokumentin elektronik, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 273/2010 “Për dokumentin elektronik”.

2. Kopja në letër e dokumentit elektronik është forma e jashtme e paraqitjes së tij.

3. Titullari i institucionit publik autorizon personin që vërteton kopjen në letër të dokumentit elektronik.

4. Kopja në letër e dokumentit elektronik ka të njëjtën vlerë ligjore me dokumentin elektronik kur realizohet në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 10 273/2010 “Për dokumentin elektronik” dhe këtë udhëzim.

5. Kopja në letër e vërtetuar si kopje e dokumentit elektronik duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) shënimin “Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik”. Ky shënim duhet të jetë në çdo faqe të kopjes në letër në një vend të dukshëm e të qartë;

b) çdo faqe e kopjes në letër të dokumentit elektronik nënshkruhet nga personi i autorizuar prej titullarit të institucionit;

c) kopja në letër e dokumentit elektronik shoqërohet me një shkresë, sipas aneksit 1 (bashkëlidhur). Kjo shkresë ngjitet në mënyrë të sigurt me kopjen në letër të dokumentit elektronik;

d) mungesa e elementeve të mësipërme cenon barasvlershmërinë ligjore të kopjes në letër të dokumentit elektronik.

6. Tarifa dhe vlera përkatëse për shërbimet që lidhen me vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik përcaktohet nga titullari i institucionit që lëshon dokumentin.

7. Kopja në letër e dokumentit elektronik trajtohet në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI PËR INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË**  
**E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT**  
**Genc Pollo**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**EMËRTIMI I INSTITUCIONIT**

Adresa:

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Dita.muaj.viti

**Lënda:** Vërtetim i kopjes në letër të dokumentit elektronik

**Vendndodhja**

**VËRTETIM**

Bazuar në pikën 1 të nenit 10 të ligjit nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik” dhe udhëzimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_2012 të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, me autorizimin nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, lëshuar nga z/znj. \_\_\_\_\_ (titullari i institucionit) \_\_\_\_\_, vërtetoj se kjo kopje në letër është:

**“Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik”**

Titulli/përshkrimi i dokumentit bashkëlidhur: \_\_\_\_\_

Numri i faqeve të dokumentit bashkëlidhur: \_\_\_\_\_ (me numra dhe shkronja)

I autorizuar:

(Emërtimi i detyrës)

(Emri/mbiemri)

(Nënshkrimi i personit të autorizuar)

(Vula e institucionit)

**VENDIM**

**Nr. 171, datë 24.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORÇA”  
SHPK PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BERZH-IT**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të asetëve si kolateral nga shoqëria “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. pranë BERZH-it, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:



Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1.1 dhe 1.2, emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).

- Neni 7 pika 1.3 germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)

- Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5. (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të asetëve të saj pranë BERZH-it.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

#### VENDIM

Nr. 172, datë 24.12.2012

### **PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË “ERMA MP” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC “CARSHOVË”, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5 pika 8, 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe Procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Erma M.P” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Carshovë”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Erma M.P” sh.p.k., është konform “rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Erma M.P” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec “Carshovë”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

#### VENDIM

Nr. 173, datë 24.12.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“BALKAN GREEN ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES  
NGA HECET “ARRAS”, “FUNARES”, “DUKAGJIN”, “NIKOLICE”, “BULQIZE”,  
“LURE”, “ORGJOST”, “LEKBIBAJ”, “VELCAN”, “ZERQAN”, “BORSH”,  
“LESHNICE”, “SHOSHAN”, “UJANIK”, “KERPICE”, “BARMASH”, “LUNIK”,  
“HOMESH”, “MUHUR”, “RAJAN”, “MARJAN” DHE “TRESKE 2”, SI BURIME TË  
RINOVUESHME ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5 pika 8, 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa “d”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Arras”, “Funares”, “Dukagjin”, “Nikolice”, “Bulqize”, “Lure”, “Orgjost”, “Lekbibaj”, “Velcan”, “Zerqan”, “Borsh”, “Leshnice”, “Shoshan”, “Ujanik”, “Kerpice”, “Barmash”, “Lunik”, “Homesh”, “Muhur”, “Rajan”, “Marjan” dhe “Treske 2”, si burime të rinovueshme energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”



Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hecet “Arras”, “Funares”, “Dukagjin”, “Nikolicë”, “Bulqizë”, “Lure”, “Orgjost”, “Lekbibaj”, “Velcan”, “Zerqan”, “Borsh”, “Leshnicë”, “Shoshan”, “Ujanik”, “Kërpice”, “Barmash”, “Lunik”, “Homesh”, “Muhur”, “Rajan”, “Marjan” dhe “Treske 2”, si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

#### VENDIM

Nr. 174, datë 24.12.2012

### **PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC “SMOKTHINA” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5 pika 8, 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa “d”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Smokthina”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike”, nga burimet e rinovueshme si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat “a”, “b”, “c”



Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec “Smokthina”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**

**Nr. 175, datë 24.12.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“FAVINA 1” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC  
“VITHKUQ”, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5 pika 8, 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Vithkuq”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec “Vithkuq”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**

**Nr. 176, datë 24.12.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“DUKA T2” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC  
“TUCEP 2”, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Duka T2” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Tucep 2”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatohet se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Duka T2” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Duka T2” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec “Tucep 2”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 177, datë 24.12.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DUKA T2” SHPK  
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TUCEP 2”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a” nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Duka T2” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Duka T2” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes (lejet nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5), është në proces miratimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Duka T2” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Tucep 2”.
2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**



**VENDIM**  
**Nr. 178, datë 24.12.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ERMA M.P”  
SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENER GjISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9; 13 pika 1 dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4; të ligjit nr. 9072, datë 22. 5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 8, 10 pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9. 9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18. 3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Erma M.P” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Erma M.P” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuar nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Erma M.P” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 179, datë 28.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT**  
**SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 112 pika 2 germa “a” të ligjit 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2012, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për një ndryshim në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

**VENDOSI:**

1. Pika 2 e vendimit nr. 93, datë 16.7.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshohet si më poshtë:

“Ky vendim do t’i shtrijë efektet deri në 31 janar 2013”.

2. Në kapitullin IX, pika 1.3.c, të ndryshohet si vijon:

“Gjeneruesit e energjisë elektrike do të jenë objekt i disbalancave sipas dispozitës së mësipërme.

Për gjeneruesit që janë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, disbalancat do të llogariten me matje (aparaturë matëse).

Për gjeneruesit që janë të lidhur në rrjetin e transmetimit, disbalancat do të llogariten me matje duke filluar që nga data 1 shkurt 2013.

KESH (Gen), në cilësinë e siguresit të balancimit, nuk është subjekt i trajtimit të disbalancave, duke filluar nga data 1 gusht 2012.

FPSH referuar Modelit të Tregut, pika 6, nuk do të jetë subjekt i trajtimit të disbalancave, duke filluar nga data 1 gusht 2012.”.

Në kapitullin IX pika 1.3.d, fjalia e fundit, ndryshon dhe bëhet si vijon:

“HEC-et e vegjël të lidhur në rrjetin e shpërndarjes nuk do të jenë subjekt i trajtimit nga disbalancat deri më 31 qershor 2013”.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.1.2013  
Doli nga shtypi më 17.1.2013

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë